



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	158/21
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	24.06.2021
VUSHTRRI - VUÇITRN	



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, në lidhje me nenin 41 paragrafi 2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës, kuvendit i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datën **24 qershor 2021** merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR APROVIM E PLANIT PËR TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

1. Me këtë vendim aprovet Plani i Trashëgimisë Kulturore 2021-2023, i Komunës së Vushtrrisë.
2. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që të ndërmerr masa për implementim të këtij plani në pajtim me autorizimet dhe përgjegjësitë ligjore duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet publike të nivelit qendror dhe organizmat tjerë të shoqërisë civile.
3. Qëllimi i hartimit të këtij plani është të përmirësoj gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunën e Vushtrrisë, të ndihmojë në integrimin e saj efektiv në kontekstin e planifikimit urban si dhe të lehtësoj integrimin e saj në qarqet ekonomike, turistike e kulturore lokale.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Plani i Trashëgimisë Kulturore 2021-2023, i Komunës së Vushtrrisë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe drejtorit tjera kompetente komunale.
6. Vendimi hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



**Nasuf Aliu**

**Kryesues i Kuvendit**



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 159/21

Nr. i fq. / Br. st - 22 -

Data: / Datum 24.06.2021

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

---

**PLANI I TRASHËGIMISË KULTURORE  
(2021-2023)**

Qershor, 2021

### **Informata të përgjithshme**

Hartimi i dokumentit "Plani Komunal për Trashëgimi Kulturorë", është realizuar nga Komuna e Vushtrrisë dhe OJQ "Forumi për Zhvillim dhe Demokraci - FODEM", në kuader të Projektit të përbashkët, financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport të Komunës së Vushtrrisë me qëllim të ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore në Komunën e Vushtrrisë. Plani për trashëgimi kulturorë do të identifikojë resurset ekzistuese të trashëgimisë kulturore dhe natyrore e të cilat do të shërbejnë si bazë për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në komunën e Vushtrrisë.

Ky plan i trashëgimisë kulturore do ta ketë formën e një liste (tabeleje) me aktivitete të cilat do të jenë rezultat i bashëveprimit të grupeve të ndryshme të interesit (hisedarëve) të angazhuar në zhvillimin lokal nëpërmjet trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Përmes këtij plani të trashëgimisë kulturore do të adresohen nevojat e imediate si dhe do të krijohet një vizion dhe mision më afatgjatë lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunën e Vushtrrisë.

### **Letërnjoftim i shkurt i Komunës së Vushtrrisë**

Vushtrria si komunë ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike. Territori i komunës së Vushtrrisë gjendet në pjesën veriore të Kosovës. Komuna shtrihet në drejtim veri-jug (gjatësia maksimale afro 34 km) dhe diç më e zgjeruar në mes (gjerësia maksimale afro 23 km) me një gjatësi të vijës kufitare prej afro 104.5 km. Territori i komunës gjendet në mes të këtyre koordinatave gjeografike: X1 : 200 50' 09" dhe X2 : 210 07' 05"; Y1 : 420 42' 20" dhe Y2 : 420 55' 12". Komuna e Vushtrrisë shtrihet në pjesën veriperëndimore të Rrafshit të Kosovës, në zonën ku afrohen bjeshkët e Shalës dhe Çyqavicës, bri lumit Sitnicë. Vushtrria është qytet historik i njohur që nga koha bizantine ilire-romake dhe me emërtime të ndryshme. Vushtrria është qendër komunale në të cilin gravitojnë 67 lokalitete të banuara. Territori i komunës përfshin një sipërfaqe prej 345 km<sup>2</sup>, gjersa në vitin 1981 në bazë të regjistrimit të popullsisë kishte 65.671 banorë me

strukturë të përzier etnike, që rreth 90% i takojnë etnisë shqiptare. Regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare të realizuara në vitin 2011 në Komunën e Vushtrrisë i ka dhënë këto rezultate: numri i banorëve të Komunës së Vushtrrisë sipas regjistrimit të popullsisë të kryer në vitin 2011 është 69.870 banorë (duke mos përfshirë një numër të popullsisë serbe që nuk kanë marrë pjesë në regjistrim), ndërsa dendësia e popullsisë është 202.5 banorë / për km<sup>2</sup>. Komuna e Vushtrrisë ka 11.872 ekonomi familjare, prej tyre 4,890 shtrihen në zona urbane dhe 6,976 në atë rurale, po ashtu ka një popullsi të re dhe të aftë për punë. Lumi Sitnicë, kanali i sistemit Ibër-Lepenc, përroskat Tërstena, e Sllakocit, e Studimes, e Smrekonicës, e Dumnicës dhe e Brusnikut konsiderohen të jenë rrjeti kryesor hidrografik i saj.

Dy të tretat e territorit të komunës është pjesë rrafshinore. Rrafshi i komunës e sidomos lugina përgjatë lumit Sitnicë është tokë me potenciale të mundshme për zhvillimin e bujqësisë intensive dhe zhvillim të agroindustrisë. Komuna e Vushtrrisë është qendër me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, falë tokës pjellore që ofron kushte të volitshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore, ku Komuna e Vushtrrisë prin në prodhimin dhe përpunimin e patates.

Vushtrria ka një infrastrukturë relativisht të mirë, duke cituar se përveç rrjetit rrugor ka një lidhje shumë të mirë me qytetet e tjera të Kosovës edhe nëpërmjet rrjetit hekurudhor. Largësia nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina, është 25 km., ndërsa nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës është 42 km.

Vushtrria ose Vicianumi, siç është quajtur përpara sipas emrit të vjetër ilir, është lokalitet antik, që daton qysh nga mesjeta, edhe para Perandorisë Romake, përkatësisht që nga koha e dardanëve. Viciania në fund të shekullit I, para l. K., pushtohet nga Perandoria Romake. Gjatë periudhës së pushtimit romak (I–V) Viciania kishte arritur një zhvillim të konsiderueshëm ekonomik dhe kulturor. Pas shkatërrimit të Perandorisë Romake, Viciania mbeti në kuadër të Bizantit. Pas ndarjes së krishterimit më 1054 në katolicizëm dhe ortodoksizëm, pjesa më e madhe e popullatës së Vicianës ishte katolike. Në shekullin XIV Perandoria Osmane filloi ta pushtojë Ballkanin dhe me këtë edhe Vushtrrinë. Gjatë shekujve XV–XVIII, Vushtrria ishte ndër qytetet më të mëdha në Ballkan, në Perandorinë Osmane dhe qendër e sanxhakut më të rëndësishëm të Perandorisë Osmane. Gjatë Luftës së Parë Botërore, përkatësisht gjatë viteve 1915–1918, Vushtrria u pushtua nga Austro-Hungaria. Në Luftën II Botërore (1941-1945) Vushtrria me

rrethinë i takonte zonës së pushtuar nga gjermanët. Në nëntor të vitit 1944, në Vushtrri u vendos administrata komuniste jugosllave deri në luftën e armatosur të popullit të Kosovës, e organizuar nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) dhe ndërhyrja e forcave të NATO-s (mars – qershor 1999) ku përfundimisht më 17 qershor 1999 u çlirua nga Serbia.

Në komunën e Vushtrrisë operojnë rreth 3838 biznese. Numri më i madhe i këtyre bizneseve janë të orientuar në veprimtari tregtare. Duke u bazuar në të dhënat Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, rreth 38.95 % e bizneseve merren me tregti, 15.50 % me transport dhe telekomunikacion, 10.21 % hynë shërbimet hoteliere, restorantet, etj.

Jeta kulturore në Vushtrri është pasuruar nga veprimtaria e shoqërive kulturore, përfshirë Ansamblin e valleve, Shoqatën Çeshme dhe një mori shoqatash tjera aktive brenda territorit të kësaj komune. Aktivitet tjetër me rëndësi është edhe Takimi i Poeteshave Shqiptare, i cili organizohet që nga viti 1976 dhe ka karakter garues me ç'rat në këtë eveniment marrin pjesë krijuese artistike nga të gjithat trojet shqiptare. Qëllimi i këtij festivali është të promovohet femra krijuese, të promovohet vlera artistike dhe të motivohen krijueset për kultivimin e poezisë së bukur.

Para luftës së fundit (1998-1999), komuna e Vushtrrisë ka pasur 9 biblioteka me një fond të begatshëm të librave (77 mijë libra) të shpërndara në bibliotekën kryesore të qytetit dhe në degët e saja në fshatrat Maxhunaj, Samadrexhë, Pantinë, Dubofc, Strofc, Dumnicë dhe Smrekonicë. Fondi i madh i librave është shkatërruar, thuajse tërësisht, gjatë luftës së fundit duke vështirësuar rifunksionalizimin e degëve të bibliotekës nëpër fshatra dhe lokalitete të komunës së Vushtrrisë.

Për adhuruesit e teatrit përkujdesën artistët e teatrit “Hasan Prishtina” të cilët performojnë vepra të ndryshme teatrale.

Disa nga monumentet e trashëgimisë kulturore në Vushtrri, që bartin vlera arkitektonike dhe që përbëjnë thesarin e trashëgimisë kulturore të Vushtrrisë por edhe të Kosovës, janë: Kështjella e qytetit, Hamami i qytetit, Çeshmja, Ura e gurit, Xhamia e Çarshisë, Xhamia Gazi Ali Beg, Xhamia Karamanli, Teqeja, varreza të ndryshme, shumë objekte të tjera banimi, si dhe komplekse të ndërtesave dhe dyqaneve të vjetra.

## **Qëllimi i Planit për Trashëgimi Kulturore**

Qëllimi i planit për trashëgimi kulturore është të përmirësojë gjendjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në komunën e Vushtrrisë, të ndihmojë në integrimin e saj efektiv në kontekstin e planifikimit urban si dhe të lehtësojë integrimin e saj në qarqet ekonomike, turistike e kulturore lokale. Një faktor i rëndësishëm i arritjes së këtyre qëllimeve është edhe bashkëpunimi i ngushtë me institucionet qendrore, si: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; si dhe organizatat ndërkombëtare. Rrjedhimisht, trashëgimia kulturore shndërrohet në resurs të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstitucional dhe multisektorial.

Për më tepër, ky plan përqëndrohet edhe në promovimin e trashëgimisë kulturore duke sjellur në pah vlerat socio-kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore në Vushtri. E gjithë kjo, ndër të tjera, do të arrihet përmes edukimit, aftësimit dhe pjesëmarrjes aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore duke krijuar forume kompetente të debatit.

## **Metodologjia**

Për të përmbushur qëllimin e përgjithshëm të planit për trashëgimi kulturore është përdorur një metodologji e ndërthurur e cila ngërthen në vete reflektimin e grupeve të ndryshme të fokusit (njohës të trashëgimisë kulturore, Organizatat e Shoqërisë Civile, zyrtarët komunal të Vushtrrisë, etj.) të përfshirë në çështjet e identifikimit, ruajtjes dhe promovimit të kësaj trashëgimie. Për këtë qëllim është mbajtur një punëtori tre ditore me përfaqësues të shoqërisë civile, zyrtarëve komunal të Vushtrrisë, si dhe njohësve të trashëgimisë kulturore. Gjatë punëtorisë, janë identifikuar sfidat madhore për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, gjendja e objekteve të trashëgimisë arkologjike si dhe janë diskutuar qasjet për ndërgjegjësimin e qytetarëve.

Për më tepër, është themeluar një grup punues për hartimin e planit për trashëgimi kulturor i përbërë nga zyrtarë komunal, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe një bashkëpunëtor i jashtëm në cilësi të ekspertit. Brenda grupit punues për hartimin e planit janë diskutuar çështje kyçe që ndërlidhen

me kapacitetet e komunës së Vushtrrisë për promovimin e trashëgimisë kulturore, harmonizimin e planit komunal me Planin Zhvillimor Komunal dhe Strategjinë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore.

Hartimi dhe aprovimi i këtij plani për trashëgimi kulturore do të trasojë rrugën për zbatimin e një numri të projekteve kapitale të mbështetura nga Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, si dhe do të aktivizoj një numër projektesh nga ana e Organizatave të Shoqërisë Civile të cilat do të kenë ndikim në ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e trashëgimisë kulturore duke përfshirë mundësitë e materializimit dhe përfitimit ekonomik nga kjo trashëgimi.

Rrjedhimisht, procesi i identifikimit, dokumentimit, interpretimit, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore do të realizohet duke u mbështetur në një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse, përmes debateve dhe reflektimeve konstruktive lidhur me mundësitë dhe sfidat që paraqiten kundruall pasurive të trashëgimisë kulturore në Komunën e Vushtrrisë, duke përfshirë edhe kritikën konstruktive të politikave të trashëgimisë kulturore. Kjo qasje, ndër të tjera, krijon ndjesi të thellë të pronësisë mbi Planin për Trashëgimi Kulturore në mesin e hisedarëve të lartëpërmendur.

### **Rezultatet e pritura**

Rezultatet e pritura gjatë realizimit të Planit për Trashëgimi Kulturore (2021-2023) janë:

- Plani komunal për trashëgimi kulturore ka identifikuar qartë prioritetet dhe qasjen proaktive për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
- Janë zotuar dhe zbatuar projekte kapitale që përmbushin qëllimin e planit në fjalë;
- Është përmirësuar dukshëm komunikimi mes hisedarëve në nivel lokal me ata në nivel qendror përmes zbatimit të qasjes së integruar në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore;
- Janë ngritur kapacitetet implementuese në nivelin komunal, përfshirë Drejtorinë e Urbanizmit dhe atë të Kulturës me Organizatat e Shoqërisë Civile duke siguruar pjesëmarrjen e gjërë në vendimmarrje në sferën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

- Përmirësimi i trashëgimisë kulturore duke i orientuar projektet në fushën e konservimit të integruar, restaurim, ngritjen e kapaciteteve për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore, përfshirë vetëdijësimin e gjërë të qytetarëve.

#### - Vizioni -

- Vushtrria me rrethinë shembull i mirë i ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore -

#### - Misioni -

- Institucionet komunale, shoqëria civile dhe qytetarët e komunës së Vushtrrisë të përkushtuar në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore si pasuri që katalizon zhvillimin e përgjithshëm shoqëror -

#### **Analiza ekzistuese e gjendjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore**

Trashëgiminë kulturore dhe natyrore në Komunën e Vushtrrisë duhet shiquar nga një prizëm më të gjërë pasi që kjo trashëgëmi ndikohet nga faktorë të ndryshëm ekonomik, social, politik dhe zhvillimor. Andaj, duke pasur parasysh kompleksitetin e trashëgimisë kulturore, ajo duhet të përfshihet dhe harmonizohet me Planin Zhvillimor Komunal duke përcaktuar qartë edhe veprimet që duhen ndërmarrë për mbrojtjen e saj.

Për të njohur faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të cilët ndikojnë në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore është bërë një analizë fillestare e gjendjes së përgjithshme në Vushtrri e cila ka shpërfaqur të gjetura valide. Kjo analizë fillestare (SWOT) është një mjet për vlerësim të gjendjes ekzistuese e cila shërben për të mbledhur ide të ndryshme nga përfaqësuesit e sektorit të caktuar, të cilët marrin pjesë në procese në mënyrë aktive. Kjo analizë është njëra nga metodat që janë përdorë në punëtori për përcaktimin e gjendjes aktuale të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Komunën e Vushtrrisë. Emri i SWOT analizës rrjedh nga shkronjat e para të fjalëve në gjuhën angleze:

**Përparësitë** – Faktorë pozitive të brendshme të trashëgimisë kulturore të komunës.

**Dobësitë** - Faktorë negative të brendshme të trashëgimisë kulturore të komunës.

**Mundësitë** – Faktorë të jashtëm të cilët mund të përmirësojnë gjendjen e trashëgimisë kulturore të komunës.

**Rreziqet** – Faktorë të jashtëm të cilët mund të rrezikojnë dhe përkeqësojnë gjendjen e trashëgimisë kulturore të komunës.

Analiza SWOT është hartuar nga përfaqësuesit e institucioneve komunale të Vushtrrisë, pjesëtarët e shoqërisë civile si dhe hisedarët tjerë gjatë një punëtorie të mbajtur në muajin shtator 2020. Grupi punues i formuar për çështjen e hartimit të këtij plani ka vazhduar me shkëmbimin e mendimeve deri në finalizimin e analizës SWOT.

T'i listojnë përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet me të cilët ballafaqohet trashëgimia kulturore e komunës së Vushtrrisë:

▪ **Përparësitë**

- Historia e begat e qytetit të Vushtrrisë me rrethinë;
- Pozita gjeografike e favorshme, duke qenë se Vushtrria shtrihet në mes të komunës së Mitrovicës, Prishtinës, Obiliqit, Skenderajt dhe Podujevës;
- Numri i madh i monumenteve të trashëgimisë kulturore në Vushtri dhe rrethinë;
- Prania e lokaliteteve arkeologjike;
- Pasuritë ujore (Sitnica, Terstena);
- Burimi i ujit mineral dhe termo-mineral;
- Prania e peizazheve natyrore;
- Tradita e lokale;
- Lokacioni i kalasë;
- Organizimi tradicional “Takimi i poeteshave shqiptare”;
- Manifestimi “Ditët e Hasan Prishtinës”;
- Manifestimi “Ditët e patates”;
- Tradita e zejtarisë dhe zhvillimit të biznesit;
- Qasja e lehtë deri te monumentet kryesore.
- Gatishmëria e institucioneve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

▪ **Dobësitë**

- Ndërtimet pa leje rreth zonës historike;
- Ndërtimet në afërsi të objekteve të trashëgimisë kulturore në kundërshtim me planin urbanistik;
- Qasja jo gjithëpërfshirëse në procesin e ruajtjes së trashëgimisë kulturore;
- Ndërveprimi jo i kënaqshëm ndër-institucional dhe mungesa e ekspertëve;
- Vetëdija e ulët ndaj trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
- Promovimi i trashëgimisë kulturore në nivel jo të kënaqshëm;
- Mungesa e tabelave të udhëzimit dhe udhëzuesve për trashëgimi kulturore;
- Buxheti i pamjaftueshëm për trashëgimi kulturore;
- Ndotja e lumenjve;
- Planet e pazbatuara për informim dhe ndërgjegjësimit për trashëgimi kulturore;
- Mungesa e angazhimit të stafit shtesë të specializuar për trashëgimi kulturore

▪ **Mundësitë**

- Revitalizimi i objekteve kryesore të trashëgimisë kulturore;
- Shfrytëzimi i urës së gurit dhe objekteve tjera të trashëgimisë për aktivitete kulturore;
- Zhvillimi i turizmit natyror dhe rekreativ.
- Vendosja e tabelave udhëzuese (sinjalistika)
- Përcaktimi i zonave (historike) të mbrojtura në Vushtri.
- Promovimi i trashëgimisë kulturore me qëllim të vetëdijësimit për rëndësinë e saj;
- Trajnimet e avancuara për trashëgiminë kulturore;
- Hulumtimi dhe evidentimi i trashëgimisë shpirtërore të komunës së Vushtrrisë;
- Zhvillimi i turizmit mbi bazën e trashëgimisë kulturore.

▪ **Rreziqet**

- Degradimi i mëtejme i objekteve të trashëgimisë kulturore;
- Ndërtimet e reja në afërsi të monumenteve të trashëgimisë kulturore;
- Vullneti i pamjaftueshëm politik;
- Ndotja dhe shkatërrimi i mëtejme i shtretërve të lumenjve;

- Trashëgimia kulturore në fund të prioriteteve qeveritare;
- Përkeqësimi i gjendjes politike dhe asaj të sigurisë në pjesën veriore të Kosovës.

### **Analiza e objektivave specifike**

Duke u mbështetur në gjetjet që derivuan nga analiza SWOT dhe domosdoshmërisë për të evituar dobësitë dhe shfrytëzuar mundësitë e përcaktuara dhe duke shfrytëzuar qasjen strategjike janë identifikuar katër grupe të objektivave specifike. Objektivat specifike janë veprime operacionale që duhen ndërmarrur në favor të mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore në Vushtrri (afatshkurtëra: 3-5 vjet / afatmesme: 5-10 vjet / afatgjata: mbi 10 vjet).

#### **Objektivi specifik I: Mbrojtja e monumenteve të trashëgimisë kulturore**

- Inventarizimi i objekteve të trashëgimisë kulturore (afatshkurtër);
- Intervenimet e mëtejme në Kala, Hamam dhe Urën e Vjetër të gurit (afatshkurtër);
- Restaurimi i vazhdueshëm i objekteve tjera të trashëgimisë kulturore (afatgjatë);
- Ndalimi i ndërtimeve të pa planifikuara në afërsi të objekteve të trashëgimisë kulturore (afatshkurtër);
- Vazhdimi i gërmimeve arkeologjike (afatmesëm);
- Trajnime profesionale për restaurues (afatmesëm).

#### **Objektivi specifik II: Funkcionalizimi i trashëgimisë kulturore në përditshmëri**

- Përcaktimi i kufinjëve të monumenteve të trashëgimisë kulturore (afatshkurtër);
- Funkcionalizimi i qendrës informuese për zonën historike të Vushtrrisë dhe monumentet tjera të trashëgimisë arkeologjike (afatshkurtër);
- Sinjalizimi adekuat i objekteve të trashëgimisë kulturore (afatshkurtër);
- Konzervimi i mëtejme i objekteve të trashëgimisë kulturore (afatgjatë);

- Funkcionalizimi adekuat i monumenteve të trashëgimisë kulturore (afatmesëm);

### **Objektivi specifik III: Shfrytëzimi i trashëgimisë kulturore si aset zhvillimor i komunës**

- Promovimi i trashëgimisë kulturore përmes botimit të një Guide turistike të detajizuar (afatshkurtër);
- Organizimi i aktiviteteve tradicionale për njohjen e trashëgimisë kulturore të Vushtrrisë, aktivitete të ecjeve të gjata (hiking), sidomos gjatë kohës së qëndrimit të mërgimtarëve (afatshkurtër);
- Organizimi i aktiviteteve tjera tradicionale të fushës së kulturës brenda perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore (afatshkurtër).

### **Objektivi specifik IV: Vetëdijësimi mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore**

- Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit për bashkësinë (afatshkurtër);
- Organizimi i fushatave mediale lidhur me trashëgiminë kulturore dhe natyrore (afatshkurtër);
- Projekte për edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjëve për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore (afatshkurtër);
- Garat e të rinjëve për eseun/poezinë më të mirë lidhur me trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Vushtrrisë (afatshkurtër);
- Gara e të rinjëve për pikturën më të mirë të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Vushtrrisë (afatshkurtër).

Në këtë mënyrë, si rrjedhojë e punëtorisë dhe diskutimeve të shumta të grupit punues u përcaktuan prioritetet dhe projektet eventuale në favor të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Vushtrrisë.

## Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore në Komunën e Vushtrrisë

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht Departamenti i Trashëgimisë Kulturore është institucioni përgjegjës për futjen nën mbrojtje të Monumenteve në territorin e Republikës së Kosovës. Gjatë hulumtimeve të bëra janë hasur lista të ndryshme por që fokusi është përqëndruar te lista zyrtare. Kjo trevë karakterizohet me trashëgimi me vlera të larta kulturore, si kalatë, urat, kullat, shtëpitë qytetare, shtëpitë fshatare dhe lokalitetet arkeologjike, të cilat për fat të keq nuk janë mbrojtur ligjërisht. Secili element, monument apo tërësi e trashëgimisë kulturore dhe natyrore është unike dhe zhdukja e cilitdo prej tyre përbën humbje definitive dhe të pakthyeshme të trashëgimisë.

Lista e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme paraqet listën zyrtare të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në këtë listë, në Komunën e Vushtrrisë gjenden gjithsej 10 lokalitete në kategorinë Trashëgimia Arkeologjike dhe 10 monumente në kategorinë Trashëgimia Arkitekturore. Në listën e fundit e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme (2015- 2016) në Komunën e Vushtrrisë janë përfshirë 16 Monumente në kategorinë Trashëgimia Arkeologjike dhe 14 Monumente në kategorinë Trashëgimia Arkitekturore, duke e rritur numrin total në 30 Monumente.

### Lista e trashëgimisë kulturore në Vushtri

Emri	Periudha	Vendi	Kategoria
Ura e Vjetër e Gurit	Mesjetë	Vushtri	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Monument/Ansambël
Ura e Vjetër e Gurit	Antikë	Vërnice	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Monument/Ansambël
Kështjella "Kalaja" e Vjetër	Mesjetë	Vushtri	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria:

			Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
Lokaliteti Arkeologjik Antik (Ligata)	Romake	Stanoc i Poshtëm	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
Lokaliteti Arkeologjik Selishtë (Çeremidëhane)	Romake	Banjiçë	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
Lokalitet Arkeologjik Antik dhe Mesjetar (Te jargavanët)	Antikë, Mesjetë	Novosellë	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
Fortesë Antikë – Gradina e Malokëve	Antikë, Mesjetë	Samadrexhë	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
Fortesë Antikë – Gjyteti i Strocit	Antikë, Mesjetë	Strofc	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
Lokaliteti Arkeologjik – Selishtë (te shpija)	Romake	Vërnice	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
Germadhat Mesjetare te Kompleksit në Kodrën Çeçan	Romake, Mesjetë	Duboc	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat

Përmendore Mbivarrore (Nishan) e Mustafë Beut në Xhaminë e Gazi Ali Beut	1538	Vushtrri	Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore Nënkategoria: Monument/Ansambël
Kisha e Shën Llazarit	Shek. XIV – Renovuar Shek. XX	Samadrexhë	Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore Nënkategoria: Monument/Ansambël
Xhamia e Gazi Ali Beut	1444	Vushtrri	Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore Nënkategoria: Monument/Ansambël
Hamami i Vjetër	Shek. XVI	Vushtrri	Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore Nënkategoria: Monument/Ansambël
Shtëpi banimi-Shaban Aga	Shek. XIX	Vushtrri	Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore Nënkategoria: Monument/Ansambël
Shtëpia e Mahmut Pashë Gjinollit	Shek. XX	Vushtrri	Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore Nënkategoria: Monument/Ansambël
Kulla e Zejnullah Beut	Shek. XX	Balincë	Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore Nënkategoria: Monument/Ansambël
Shtëpia e Zymer Musiqit	Shek. XVII	Ceceli	Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore Nënkategoria: Monument/Ansambël
Kulla e Kadri Hysenit	Shek. XIX	Ashlan	Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore Nënkategoria: Monument/Ansambël

Shtëpia e Familjes Pantina	Shek. XX	Vushtrri	Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore Nënkategoria: Monument/Ansambël
----------------------------	----------	----------	--

Monumentet ekzistuese në komunën e Vushtrrisë faktojn të kaluarën e bujshme të saj si qendër urbane e rëndësishme dhe një nga qytetet më të vjetra në Kosovë. Për më tepër, këto monumente dëshmojnë se Vushtrria është lokacion antik, mesjetar dhe bashkëkohor i cili ka luajtur rol të rëndësishëm ekonomik dhe kulturor në faza të ndryshme historike. Gjatë periudhave të ndryshme kohore, pushtuesit e ndryshëm (romakët, turqit dhe sllavët) kanë lënë gjurmë të dukshme në trashëgiminë kulturore përmes objekteve të ndryshme (xhami, kisha, kulla, ura, hamame, etj). Përveç lashtësisë së saj, Vushtrria njihet për trashëgiminë e begatshme kulturore, historike dhe arkeologjike. Këto objekte kanë rëndësi të madhe ngase dëftojn për mënyrën e jetesës, kulturën, besimet fetare dhe sundimet e huaja.

Përbrenda qytetit të Vushtrrisë, gjenden monumentet dhe tërësitë e trashëgimisë kulturore që janë të evidentuara në listën e MKRS-së për mbrojtje të përkohshme. Disa e gëzojnë mbrojtjen prej 50 – 60 vitesh, ndërsa të tjera janë me statusin e propozuar përbrenda kësaj liste.

1. Ura e vjetër e gurit, është e shpallur si zonë e veçantë e mbrojtur;
2. Kështjella “Kalaja”, Kulla e vjetër, nr. vendimit: 858/ 49;
3. Nishani i Mustafë Beut në xhaminë e Gazi Ali Beut, 1538, nr. vendimit: 02 - 957/66;
4. Xhamia e Gazi Ali Beut, 1444, nr. vendimit: 02 -985/66;
5. Hamami i vjetër, shekulli XVI, nr. vendimit: 02 -628/68;
6. Shtëpi – Shaban Aga, shek. XIX;
7. Shtëpi - Mahmut Pashë Gjinolli, shek. XX.

### **Gjendja e objekteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje**

Vushtrria, si njëri nga qytetet më të vjetra në Kosovë, me një zhvillim të konsiderueshëm ekonomik dhe shoqëror në epoka të ndryshme historike, sot ka pak ndërtime dhe tërësi të ruajtura për ta dëshmuar këtë të kaluar të lavdishme. Shumë pjesë të qytetit të vjetër janë shkatërruar dhe


degraduar pas luftës së dytë botërore. Ky degradim ka vazhduar edhe gjatë periudhës së zhvillimit modern të qytetit, mirëpo shkatërrimin më të madh qyteti e ka pësuar në luftën e fundit në Kosovë.

Fatëkeqësisht, ky degradimi vazhdoi edhe pas luftës duke qenë se prioritetet e qeverisjes ishin të përqëndruara në çështje jetike të mbijetesës dhe ofrimit të të mirave publike bazike për qytetarët. Rrjedhimisht, janë bërë intervenime të shumta edhe në prona të trashëgimisë kulturore duke i dëmtuara ato dhe duke rënë ndesh me normat vendore dhe ndërkombëtare lidhur me parimet e konservimit të një monumenti të trashëgimisë, etj.

Gjendja e trashëgimisë kulturore në Vushtrri duke përfshirë të gjitha kategoritë ligjore të trashëgimisë kulturore nuk është e mirë, janë bërë hapa të rëndësishëm mirëpo në nivelin e përgjithshëm ka hapësirë të theksuar që lenë për të dëshiruar. Buxheti i ndarë për trashëgimi kulturore është i pamjaftueshëm për të ngritur mekanizmat e kontrollit dhe të sigurohet cilësia në trajtimin profesional në përputhje më standardet dhe kriteret ndërkombëtare. Po ashtu duhet të sigurohet vlerësim profesional dhe ligjor i të gjitha projekteve në fushën e trashëgimisë kulturore. Gjithashtu edhe planifikimi që është bërë nga MKRS në këtë mënyrë, me projekte të përsëritura për vite të tëra, pa një plan veprimi konkret dhe investime në objekte të cilat nuk e kanë statusin e asetit të trashëgimisë kulturore, nuk do të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së trashëgimisë kulturore në Vushtrri. Prioritet për investime duhet të kenë asetet e trashëgimisë kulturore në mbrojtje.

Trashëgimia kulturore në Vushtrri sot përveç që ka nevoja të mëdha për intervenime dhe përmirësim të gjendjes fizike, duhet bërë promovimi përmes botimeve dhe publikimeve shkencore. Prandaj, një pjesë e konsiderueshme e mjeteve financiare duhet të ndahen për këtë destinim.

## ANALIZA E GJENDJES – Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore



### Prioritetet e Planit për Trashëgimi Kulturore të Vushtrisë (2021-2023)

Është e qartë se Plani për Trashëgimi Kulturore (2021-2023) është kryesisht i përqëndruar në vetëdijësimin e qytetarëve dhe krijimin e partneritetit me institucionet komunale me qëllim të promovimit, mbrojtjes si dhe shfrytëzimit të saj në katalizimin e veprimtarisë ekonomike në komunën e Vushtrisë (turizmit).

Andaj, në përmbushjen e këtij qëllimi do të realizohen këto projekte:

**1. Ndalimi i ndërtimeve të pa planifikuara në afërsi të objekteve të trashëgimisë kulturore:**

Ky aktivitet është tejet i rëndësishëm nga fakti se krijon parakushte për restaurimin dhe konzervimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe mundëson shfrytëzimin efektiv për aktivitete kulturore dhe ato turistike. Ndër të tjera, ky aktivitet është thelbësor për ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Në përmbushjen e këtij aktiviteti rolin kryesor do ta luajnë institucionet komunale përmes organeve të tyre (inspektorateve). Gjithashtu, qytetarët dhe shoqëria civile mund të luajnë rol të rëndësishëm në përmbushjen e këtij synimi përmes aktivizimit qytetar.

**2. Përcaktimi i kufinjëve të monumenteve të trashëgimisë kulturore:** Ky aktivitet është i një prioriteti të madh ngase parandalon çfarëdo intervenimi të pa autorizuar dhe degradimi të objekteve të trashëgimisë kulturore. Përcaktimi i kufinjëve të monumenteve të trashëgimisë kulturore mund të bëhet përmes aktivitetetve të zonimit dhe përpilimit të Hartave Zonale Komunale e të cilat janë pjesë e Planit Zhvillimor Komunal. Ky aktivitet pritet të ndërmerret nga Drejtoria Komunale për Urbanizëm në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë Komunale për Kulturë dhe atë të Kadastrës. Në mbarëvajtjen e këtij aktiviteti mund të ndihmoj edhe shoqëria civile në Vushtri.

**3. Funkcionalizimi i qendrës informuese për zonën historike të Vushtrrisë dhe monumentet tjera të trashëgimisë arkeologjike:** Me qëllim të funksionalizimit të trashëgimisë kulturore në Vushtri dhe përfitimin nga kjo trashëgimi duhet funksionalizuar një qendër informuese në kuadër të të cilës angazhohen të paktën dy njohës të mirë të trashëgimisë kulturore. Qendra duhet pajisur me material të mjaftueshme informuese për trashëgiminë kulturore por edhe të ketë mundësi të organizimit të vizitave objekteve të ndryshme të trashëgimisë për nevojat e turistëve. Kjo qendër mund të kordinohet edhe nga shoqëria civile në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë Komunale për Kulturë.

**4. Sinjalizimi adekuat i objekteve të trashëgimisë kulturore:** procesi i sinjalizimit të trashëgimisë kulturore është tejet i rëndësishëm dhe është zhvilluar në mënyrë të pjesshme. Një pjesë e këtij sinjalizimit duhet ndërruar tërësisht duke e zëvendësuar me forma më adekuate si dhe

të vazhdohet deri në mbulimin me sinjalizim të të gjitha objekteve të trashëgimisë kulturore. Ky aktivitet mund të përkrahët nga institucionet komunale ose MKRS nën mbikëqyrjen e DKRS.

**5. Promovimi i trashëgimisë kulturore përmes botimit të një Guide turistike të detajzuar:**

Ekziston nevoja e pasurimit të materialit informues për trashëgimi kulturore dhe për këtë arsye guidat ekzistuese do të pasurohen me ato të detajzuara të cilat jepin informacione shtesë me qëllim të ngjalljes së kërshërisë së turistëve potencial. Pra, krahas materialit ekzistues duhen dizajnuar edhe guida të detajzuar dhe të përkthyer në gjuhë të ndryshme. Ky aktivitet është përgjegjësi e Drejtorisë Komunale për Kulturë e që mund të zhvillohet në bashkëpunim me shoqërinë civile.

**6. Aktiviteteve tradicionale për njohjen e trashëgimisë kulturore të Vushtrrisë:**

Me qëllim të katalizimit të zhvillimit të komunës së Vushtrrisë të shfrytëzohen pasuritë kulturore, arkeologjike dhe natyrore. Në këtë vazhdë, të organizohen aktivitete tradicionale të ecjeve të gjata (hiking), sidomos gjatë kohës së qëndrimit të pjesëtarëve të diasporës. Këto aktivitete mund të organizohen nga Drejtoria e Kulturës në bashkëpunim me shoqërinë civile në Vushtri, me ç'rast mund të kyçen edhe bizneset vushtrriase apo edhe ekonomitë familjare të pjesëve rurale të Vushtrrisë.

**7. Aktiviteteve tjera tradicionale të fushës së kulturës brenda perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore:**

Organizimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore brenda perimetrit të objekteve të trashëgimisë arkologjike dhe arkitektonike do të ndikonte dukshëm në promovimin dhe mbrojtjen e kësaj trashëgime si dhe në materializimin ekonomik të saj. Aktivitetet si ekspozitat e artit figurativ, skulpturës, ditëve të poezisë, shfaqjeve teatrale, promovimit të veprave artistike, do të organizohen brenda perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore. Kjo do të organizohet nga Drejtoria e Kulturës në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe shoqatat e ndryshme kulturore të Vushtrrisë.

**8. Fushatat e ndërgjegjësimit për trashëgiminë kulturore:**

Aktivitetet ndërgjegjësuese mund të organizohen nga DKRS në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile. Për më tepër, aktivitetet e tilla do të implementohen nga vet organizatat e shoqërisë civile të mbështetura nga institucionet komunale në Vushtri dhe Ministria e Kulturës poashtu. OSHC-të janë të profesionalizuara në hartimin dhe zbatimin e fushatave të ndryshme andaj partneriteti i institucioneve komunale me shoqërinë civile është i domosdoshëm në përmbushjen e objektivave të ndërgjegjësimit qytetarë.

**9. Fushatat mediale për trashëgiminë kulturore:** Gjatë periudhës 2021-2023, të organizohen fushata mediale çdo vjet me qëllim të ndërgjegjësimit të gjërë të qytetarëve për trashëgiminë kulturore. Për këtë qëllim mund të organizohen debate tematike në Radio Televizionet lokale, rajonale dhe ato nacionale ku në qendër të debateve të jenë ruajtje dhe promovimi i trashëgimisë kulturore. Ky aktivitet të organizohet nga Drejtoria për Kulturë në bashkëpunim me shoqatën e Historianëve të mbështetur nga projektet e shoqërisë civile dhe institucioneve qendrore.

**10. Garat e të rinjëve për eseun/poezinë më të mirë:** Aktivitet që mund të organizohet brenda perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe i dedikohet vet kësaj trashëgime. Veprat e të rinjëve duhet të kenë temë qendrore trashëgiminë kulturore dhe të organizohen nga Drejtoria e Kulturës në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe krijuesit vushtrrias. Aktiviteti të mbështetet nga institucionet komunale, institucionet qendrore dhe shoqëria civile.

**11. Garat e të rinjëve për pikturën më të mirë:** Aktivitet që mund të organizohet brenda perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe i dedikohet vet kësaj trashëgime. Veprat e të rinjëve duhet të kenë temë qendrore trashëgiminë kulturore dhe të organizohen nga Drejtoria e Kulturës në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe artistët/piktorët vushtrrias. Aktiviteti të mbështetet nga institucionet komunale dhe institucionet qendrore.

Prioritetet e Planit për Trashëgimi Kulturore (2021-2023): Komuna e Vushtrrisë						
Nr.	Projekti	Vlera e projektit	Kohëzgjatja	Inicues	Implementues	Relevanca
1.	Ndalimi i ndërtimeve të pa planifikuara në afërsi të objekteve të trashëgimisë kulturore	//////////////////// //	2021-2023	DKRS	Drejtoria e Urbanizmit dhe Inspektorati Komunal	- PLTK - PZHK
2.	Përcaktimi i kufinjëve të monumenteve të trashëgimisë kulturore	//////////////////// //	2021 - 2023	DKRS	- Drejtoria e Urbanizmit; - Kadastra; - Inspektorati Komunal	- PLTK - PZHK

3.	Funksionalizimi i qendrës informuese për zonën historike të Vushtrrisë dhe monumentet tjera të trashëgimisë arkeologjike	12, 000. <sup>00</sup> € në vit x 3 vite = 36, 000. <sup>00</sup> €	2021- 2023	DKRS	MKRS DKRS QRTK	- PLTK
4.	Sinjalizimi adekuat i objekteve të trashëgimisë kulturore	9, 000. <sup>00</sup> €	2021- 2023	DKRS	MKRS DKRS QRTK	- PLTK - PZHK
5.	Promovimi i trashëgimisë kulturore përmes botimit të një Guide turistike të detajizuar	10, 000. <sup>00</sup> €	2021- 2023	DKRS	MKRS DKRS QRTK OJQ	- PLTK
6.	Aktivitetet tradicionale për njohjen e trashëgimisë kulturore të Vushtrrisë (ecje të gjata - hiking)	6, 000. <sup>00</sup> €	2021- 2023	DKRS	DKRS OJQ	- PLTK
7.	Aktivitetet tjera tradicionale të fushës së kulturës brenda perimetrit të objekteve të trashëgimisë kulturore (eksponat e artit figurativ, skulpturës, ditëve të poezisë, shfaqjeve teatrale, promovimit të veprave artistike)	12, 000. <sup>00</sup> €	2021- 2023	DKRS	DKRS OJQ	- PLTK
8.	Fushatat e ndërgjegjësimit për trashëgiminë kulturore	12, 000. <sup>00</sup> €	2021- 2023	DKRS	DKRS OJQ	- PLTK - PZHK
9.	Fushatat mediale për trashëgiminë kulturore	7, 500. <sup>00</sup> €	2021- 2023	DKRS	DKRS OJQ	- PLTK - PZHK
10.	Garat e të rinjëve për eseun/poezinë më të mirë	6, 000. <sup>00</sup> €	2021- 2023	DKRS DKA	DKRS OJQ	- PLTK - PZHK
11.	Garat e të rinjëve për pikturën më të mirë	7, 500. <sup>00</sup> €	2021- 2023	DKRS DKA	DKRS OJQ	- PLTK - PZHK
Total i vlerës së PLTK (2021-2023):		<b>106, 000.<sup>00</sup> €</b>	<b>2021- 2023</b>	<b>DKRS</b>	<b>DKRS MKRS QRTK OJQ</b>	<b>- PLTK - PZHK</b>

**Shënim: Në vazhdim gjeni listën e shkurtesave për institucionet përkatëse të aplikuar ne tabelat e mësipërme:**

*QRTK-MI -Qendra Rajonale e Trashëgimis Kulturore-Mitrovicë*

*PLTK -Plani Lokal i Trashëgimisë Kulturore*

*PZHK - Plani Zhvillimor Komunal*

*IAK -Instituti Arkeologjik i Kosovës*

*TKN -Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore*

*DKRS -Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport*

*DKA - Drejtoria Komunale e Arsimit*

*OJQ -Organizata jo qeveritare*

*MKRS -Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve*

### **Miratimi, monitorimi dhe zbatimi i planit për trashëgimi kulturore**

Plani për Trashëgimi Kulturore i komunës së Vushtrrisë është dokument strategjik i cili materializon Strategjinë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore (2017-2027) duke synuar përmbushjen e objektivave 4 dhe 5 (Promovimin e trashëgimisë kulturore dhe komponentën e edukimit dhe pjesëmarrjes aktive në mbrojtjen e saj) brenda periudhës kohore 2021-2023.

Pra, ky plan do të fokusohet në objektiva reale dhe lehtë të matshme, përmbushja e të cilave është parakusht për realizimin e qëllimit të përgjithshëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Pas miratimit të Planit për Trashëgimi Kulturore (2021-2023) nga Kuvendi Komunal si organi më i lartë përfaqësues, ky dokument do të zbatohet nga ekzekutivi i komunës dhe trupat e përbashkëta të Kuvendit Komunal, siç janë komitetet e ndryshme obligative dhe profesionale duke përfshirë edhe forumet e ndërtuara nga institucionet komunale dhe shoqëria civile. Kjo veprimtari monitoruese do të zhvillohet edhe në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore.

Zyra e kryetarit të komunës në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Kulturë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, janë përgjegjës për zbatimin e këtij plani.

Me qëllim të zbatimit dhe realizimit të masave të parapara në Planin për Trashëgimi Kulturore në Komunën e Vushtrrisë, do të llogaritet kostoja financiare për çdo masë, e cila duhet të jepet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Komuna apo edhe të sigurohen fonde edhe nga donatorë ndërkombëtar. Në këtë aspekt, pritshmëritë për përkrahjen financiare në zbatimin e këtij plani janë të orientuara nga MKRS-ja dhe Komuna e Vushtrrisë. Ndërtimi i partneritetit, shoqëri civile-institucione publike, është parakusht për zbatimin me sukses të këtij plani komunal për trashëgimi kulturore.

Plani për trashëgimi kulturore do të inhiboj një mori aktivitete të cilat do të sjellin në pah begatinë e komunës së Vushtrrisë, vizibilitetin e institucioneve komunale dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.

Për më tepër, ky plan për mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore ndërlidhet ngushtë edhe me planin komunal për pjesëmarrje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse ngase mbështetet në kontributin e shoqërisë civile, grupeve afariste dhe qytetarëve në përgjithësi. Ndër të tjera, përmbushja e objektivave dhe zbatimi i aktiviteteve të Planit për Trashëgimi Kulturore mund të vlerësohen si indikatorë të përmbushjes së pjesshme të Planit për pjesëmarrje të qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel komunal.

Për zbatimin e këtij plani obligohen; zyra e kryetarit të komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Nasuf Aliu**



**Kryesues i Kuvendit**